**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# <u>SKELETKURRIKULI</u>

## Për Profilin Mësimor

# MOBILERI DHE TAPICERI

## Niveli III i KSHK

**(1 vjeçar)**

## (Në drejtimin mësimor "Përpunim druri")

## Kodi: C1-III-23

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2023**

## Përmbajtja:

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i Kornizës shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor "Përpunim druri".**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin **"**Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin **"**Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.**
**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

# I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Përpunim druri”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Përpunim druri”, është “zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet e mobilerisë dhe tapicerisë”. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

– mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
– mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
– mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
– mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
– mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
– mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
– mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

# II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK.

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Mobileri dhe tapiceri” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- në se kanë aftësi të kufizuar shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin;

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

– Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

**3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II i KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një bisnesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të skicojë skema të objekteve të ndryshme prej druri, mobilje, dyer, dritare, shkallë druri etj.
- Të organizojë vendin e punës për realizimin e punimeve të objekteve prej druri dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punime prej druri.
- Të kryejë matje dhe shënime në elementet prej druri dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.
- Të kryejë punime me mjete të mekanizuara të drurit.
- Të kryejë punime me makinat bazë të përpunimit të drurit.
- Të kryejë punime me makina të avancuara të përpunimit të drurit.
- Të kryejë montime artizanale objekteve të ndryshme prej druri
- Të kryejë montime në linja zinxhir të mobiljeve
- Të kryejë punime me makinat e lustrimit
- Të kryejë punime me makina të montimit të drurit.
- Të kryejë punime të përkuljes së drurit.
- Të realizojë punime të thjeshta, në dru dhe pllaka me bazë druri, si veshje me rimeso, teni, letër dhe PVC.

- Të kryejë riparime  në repartin e montimit, gjatë veshjes së brinjëve me teni, rimeso, plastikë etj.
- Të përgatisë sipërfaqen, e drurit dhe pllakave me baze druri, për ngjitje.
- Të përgatisë lëndët ngjitëse, të drurit, sipas recetës
- Të realizojë punime  ngjitjeje me elementët prej druri
- Të realizojë imitime të thjeshta të drurit.
- Të përdorë  pajisje dhe makina të imitimit të drurit.
- Të përgatisë sipërfaqen, e drurit dhe pllakave me bazë druri, për lustrim.
- Të përgatisë lëndën lustruese të  drurit sipas recetës.
- Të realizojë punime të lustrimit në dru dhe pllaka me baze druri.
- Të kryejë riparime të defekteve mbas lustrimit, patinimit.
- Të realizojë  aplikime në dru të lëndëve kimike për ta  mbrojtur atë.
- Të kryejë punime të thjeshta me prodhime gjysëm të gatshme prej druri.
- Të vendosë aksesorë  metalikë në objekte me bazë druri.
- Të kryejë montime në objekte  mobilerie me pllakë zdrukthi, fibër.
- Të kryejë punime të mirëmbajtës dhe restaurimit të objekteve, të reja dhe të vjetra  prej druri dhe me material  gjysmë të gatshme.
- Të përdorë vegla, pajisje dhe makina të tapicerisë.
- Të përgatisë skelete të objekteve të tapicuara.
- Të kryejë punime për veshjen e dyshemesë me parket
- Të kryejë punime për ndërtimin e shkallëve prej druri.
- Të përgatisë materiale të tapicerisë.
- Të realizojë tapicerinë e mobiljeve me bazë suste dhe sfyngjeri.
- Të realizojë tapicerinë e mobiljeve me bazë sfyngjeri dhe materiale të tjera.
- Të kryejë punime të riparimeve dhe restaurimeve në tapiceri
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Të përdorë mjete dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të komunikojë me etikë profesionale.

## 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me Certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës në zdrukthtari, në ndërmarrje të ndryshme private / shteterore që kryejnë punime të objekteve prej druri, mobilerisë dhe tapicerisë, ose të vetepunesohet.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e "Maturës shetërore profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK

| Plani mësimor për profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK (1 vjeçar) | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9** (272/306) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 |
| 6 | | TIK | 1 |
| 7 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7** (238) |
| 1 | L-17-157-22 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-09-162-23 | Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit | 2 |
| 3 | L-09-163-23 | Ndërtimi i objekteve prej druri | 2 |
| 4 | L-09-164-10 | Ndërtimi i objekteve të tapicuara | 1 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **12** (408) |
| 1 | M-09-1896-23 | Punime druri me mjete të dorës dhe me makina | 69 |
| 2 | M-09-1546-23 | Punimi i dritares dhe derës prej druri | 84 |
| 3 | M-09-419-19 | Punime veshje me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme | 69 |
| 4 | M-09-420-23 | Punime montimi të objekteve prej druri | 66 |
| 5 | M-09-1897-23 | Patinimi, llustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve | 69 |
| 6 | M-09-1548-19 | Punimi i mobiljes së tapicuar në skelete të ndryshme | 51 |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar** (Gjithsej) | **3** |
| 1 | M-09-1898-23 | Punime për përkuljen e drurit | 51 |
| 2 | M-09-1899-23 | Punime për prodhimin e mobiljeve në linja zinxhir | 51 |
| 3 | M-09-1551-19 | Punime për shtrimin e dyshemesë me parket | 51 |
| 4 | M-09-1552-19 | Punimi i skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31** (1020/ 1054) |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:
Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Mobileri dhe tapiceri”, niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Mobileri dhe Tapiceri”.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e mobilerisë dhe tapicerisë.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor "Mobileri dhe tapiceri", niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës për këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III i KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 – 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 3 orë |
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 3 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 9** | Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 4 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 4 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |
| **Tema 19** | Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës | 4 orë |

**2. Lënda "Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit"(L-09-162-23) Kl. 12- 68 orë**

- **Synimet e lëndës "Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit", kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Vegla dhe makineritë e përpunimit të drurit", kl. 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë parimin e punimit me kopjim.
- Të lexojnë skemat e punës të makinave frezë, kopjuese me zinxhirë etj,
- Të përshkruajnë funksionimin dhe mekanizmat e lëvizjes të makinave frezë, kopjuese me zinxhirë etj,
- Të shpjegojnë mënyrën e punimit me makinat frezë, kopjuese me zinxhirë etj,
- Të rendisin punimet që kryhen me makinat e frezimit të drurit.
- Të lexojnë skemat e punës të makinave të thithëzimit.
- Të përshkruajnë vecoritë e ndërtimit dhe funksionimin e makinave të thithëzimit.
- Të përshkruajnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e thithëzimit
- Të listojnë proceset e punës që kryhen në makinat e thithëzimit.
- Të klasifikojnë makinat e tornimit.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinës torno universale.
- Të shpjegojnë vecoritë e ndërtimit dhe punimit të tornos kopjuese.
- Të rendisin llojet e punimeve që kryhen në makinën torno.
- Të klasifikojnë instumentat e frezimit.
- Të rendisin llojet e punimeve që kryhen në makinën torno.
- Të përshkruajnë vecoritë e ndërtimit dhe funksionimit të makinave të mprehjes.
- Të tregojnë llojet e punimeve që kryhen në makinat e shpimit te drurit.
- Të rendisin veprimet e përgatitjes të makinës për punë dhe procesit të mprehjes.
- Të listojnë tipet e makinave me shumë punto.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave me shumë punto.
- Të përshkruajnë përgatitjen për punë, mënyrën e punimit në makinat me shumë punto.
- Të rendisin proceset e punës që kryhen në këto makina.
- Të lexojnë skemat e punës të makinave të shkurtimit në saktësi dhe formatizimit.
- Të përshkruajnë veçoritë e ndërtimit të makinave të formatizimit.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e formatizimit.
- Të dallojnë makinat e kalibrimit nga ato të rrashinimit.

- Të përshkruajë  përgatitjen e makinës frezë kopjuese CNC.(makinë kontroll numerik) për punë sipas normave.
- Të  shpiegojë mënyrën e punimit të makinës CNC. sipas procesit të punës.
- Të shpiegojë programimin e makinës skuadruese sipas përmasave në skicë.
- Të shpiegojë gradimin e  grupeve të punës në makinën borduese sipas materialit bordues.
- Të shpiegojë programimin e makinës borduese sipas procesit të punës.
- Të shpiegojë gradimin e makinës sipas lloit të aksesorit metalik që do montojë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës ”Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit” kl 12- 68 orë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Parimi i kopjimit në dru | 4 ore |
| **Tema 2** | Makinat e frezimit | 9 ore |
| **Tema 3** | Punimet në makinat e frezimit | 9 ore |
| **Tema 4** | Makinat e thithëzimit | 8 ore |
| **Tema 5** | Makinat e tornimit | 6 orë |
| **Tema 6** | Instrumenta të frezimit dhe mirëmbajtja e tyre | 9 ore |
| **Tema 7** | Instrumenta të tornimit dhe mirëmbajtja e tyre | 4 ore |
| **Tema 8** | Makinat e shpimit me shumë punto | 6 orë |
| **Tema 9** | Makinat e kalibrimit dhe formatizimit | 8 orë |
| **Tema 10** | Makinat e avancuara të përpunimit të drurit  CNC | 5 orë |

**3. Lënda “Ndërtimi i objekteve prej druri”(L-09-163-23).   Kl.  12 - 68 orë**

- **Synimet e lëndës ”Ndërtimi i objekteve prej druri”, kl. 12 - 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ndërtimit i objekteve prej druri” nxënësit duhet:
- Të klasifikojnë veglat, pajisjet, makinat në ndërtimin e mobiljeve.
- Të dallojnë veglat nga pajisjet për montim
- Të përshkruajnë vecoritë e ndërtimit dhe funksionimit të pajisjeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e përdorimit të pajisjeve për montim.
- Të klasifikojnë veglat, paisjet dhe makinat për veshjen e brinjëve të pllakave e detaleve.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe përdorimin e pajisjes për veshjen e brinjëve me teni, plastikë, rimeso etj.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e linjës të mekanizuar (ose makinës) për veshjen e brinjëve.
- Të përshkruajë mënyrën e rimesimit të sipërfaqeve prej druri dhe pjesë të mobiljes me rimeso dekorative
- Të klasifikojnë mënyrat e montimit të mobiljeve.
- Të shpjegojnë mënyrën e montimit artizanal të mobiljeve.
- Të rendisin rradhën e veprimeve për montim të mobiljeve.
- Të përshkruajnë montimin e mobiljeve në linja zinxhir.
- Të shpjegojnë vecoritë e funksionimit të montimit të mobiljeve në linja konvejer
- Të listojnë anët pozitive dhe negative të montimit artizanal nga linja zinxhire.
- Të përcaktojnë përafërsisht kohën mesatare të montimit të një objekti.
- Të shpjegojnë vecoritë e ndërtimit dhe përdorimit të mobiljeve të përkulura.
- Të përshkruajnë pajisjet dhe makineritë për përkulje.

- Të rendisin veprimet për përkuljen e drurit pa trajtim.
- Të shpjegojnë procesin e përkuljes të drurit me avullim.
- Të shpjegojnë procesin e lustrimit dhe rëndësinë e tij.
- Të listojnë mënyrat e lustrimit.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjes për lustrim me sprucim.
- Të përshkruajnë procesin e lustrimit me pajisje sprucimi.
- Të shpjegojnë procesin e përpunimit të shtresës të llakut dhe tharjen.
- Të shpiegojë programimin e makinës lustruese.
- Të shpiegojë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e lustrimit.
- Të shpjegojnë parimin e imitimit të drurit dhe rëndësinë e tij.
- Të listojnë mënyrat e imitimit të drurit.
- Të përshkruajnë procesin e imitimit me dorë.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e paisjeve dhe makinave të imitimit.
- Të përshkruajnë procesin e imitimit me makina.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të patinimit.
- Të përshkruajnë procesin e patinimit me makina.
- Të shpjegojnë mënyrën e riparimit, në repartin e montimit, gjatë veshjes së brinjëve me teni, rimeso, plastikë etj.;
- Të shpjegojnë procesin e riparimit të defekteve mbas lustrimit, patinimit;
- Të shpjegojnë procese pune të riparimeve në tapiceri.
- Të përshkruajnë procesin e mirëmbajtës dhe restaurimit të objekteve, të reja dhe të vjetra prej druri dhe me material gjysmë të gatshme;
- Të përshkruajë mënyrën e rimesimit të sipërfaqeve prej druri dhe pjesëve të mobiljes me rimeso dekorative.
- Të përshkruajnë ndërtimin e objekteve prej druri që shërbejnë në sektorin e ndërtimit si dyer dritare, shkallë druri, parmakë helikoidalë për shkallë të ndryshme, veçoritë e shtrimit të dyshemesë me parket apo dërrasë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës”Ndërtimi i objekteve prej druri” kl. 12- 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Veglat për ndërtimin e mobiljeve | 4 orë |
| **Tema 2** | Pajisjet dhe makineritë për ndërtimin e mobiljeve | 7 orë |
| **Tema 3** | Veshja në brinjë e pllakave dhe detaleve. | 5 orë |
| **Tema 4** | Montimi artizanal i mobiljeve | 5 orë |
| **Tema 5** | Montimi në linja zinxhir, konvejer | 7 orë |
| **Tema 6** | Përkulja e drurit | 4 orë |
| **Tema 7** | Përkulja e drurit me avullim | 6 orë |
| **Tema 8** | Patinimi i drurit | 5 orë |
| **Tema 9** | Imitimi i drurit | 5 orë |
| **Tema 10** | Lustrimi i drurit | 8 orë |
| **Tema 11** | Riparime dhe restaurime të objekteve prej druri | 4 orë |
| **Tema 12** | Ndërtimi i objekteve të tjera prej druri | 8 orë |

**4. Lënda "Ndërtimi i objekteve të tapicuara"(L-09-164-10). Kl. 12 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës "Ndërtimi i objekteve të tapicuara", kl. 12 -34 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Ndërtimi i objekteve të tapicuara" nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë veçoritë e konstruksineve për skeletet e objekteve të tapicuara.
- Të listojnë tipet e skeleteve mbi bazën e materialeve të ndërtimit të tyre.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe montimin e skeleteve të objekteve të tapicuara me bazë druri.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe montimin e skeleteve metalike, plastik etj.
- Të rendisin veglat,paisjet dhe makinat që përdoren për tapicerinë.
- Të llogarisin sasinë e materialeve bazë e të tjera që përdoren për një objekt të tapicuar.
- Të përshkruajnë procesin e prerjes dhe qepjes të materialit të veshjes.
- Të përshkruajnë procesin e përgatitjes të materialeve për mbushje.
- Të shpjegojnë procesin e krijimit të bazës të tapicerisë me susta dhe sfyngjer.
- Të përshkruajnë procesin e qepjes së dyshekut të materialit mbushes e të veshjes.
- Të përshkruajnë procesin e qepjeve dhe vendosjen e elementeve dekorativë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Ndërtimi i objekteve të tapicuara", kl. 12- 34 orë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Tapiceria dhe vecoritë e teklogjisë së saj | 2 orë |
| **Tema 2** | Veglat, pajisjet dhe makinat për tapiceri | 5 orë |
| **Tema 3** | Përgatitja e skeleteve të objekteve të tapicuara | 6 orë |
| **Tema 4** | Përgatitja e materialeve të tapicerisë | 8 orë |
| **Tema 5** | Tapiceria e mobiljeve me bazë suste dhe sfyngjeri | 7 orë |
| **Tema 6** | Tapiceria e mobiljeve me bazë sfyngjeri dhe materiale të tjera | 6 orë |

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli: “Punime druri me mjete të dorës dhe me makina”

**Drejtimi: Përpunim druri**
**Profili: Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PERSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME DRURI ME MJETE TË DORËS DHE ME MAKINA.** | **(M-09-1896-23)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime në materialin drunor, me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II Të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi përgatit vendin e punës**<br>***Kriteret e vlerësimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta, në materialin drunor, me mjete të mekanizuara të dorës dhe makina të ndryshme të përpunimit të drurit;<br>– të përzgjedhë materialin e nevojshëm sipas standardit dhe modelit të skicës;<br>– të përcaktojë veglat, pajisjet dhe makinat sipas proceseve të punës;<br>– të përzgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;<br>– të përcaktojë rradhën e punës sipas procesit teknologjik të përpunimit të detaleve;<br>– të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;<br>– të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;<br>– të përzgjedhë instrumentat përkatëse sipas mjeteve të mekanizuara të dorës dhe makinave;<br>– Të montojë me saktësi instrumentin në makinën përkatëse sipas manualit; | |

- Të kontrollojë gatishmërinë e instrumentit për punë sipas procesit dhe cilësisë në skicë;
- Të kontrollojë funksionimin e makinës për të evidentuar defekte mekanike dhe elektrike sipas manualit;
- Të regjistrojë makinën për punë, duke e pajisur me shabllonet përkatëse sipas proceseve;
- Të kontrollojë saktësinë e regjistrimit dhe të punimit në makineri sipas procesit;
- të vendosë me kujdes, materialin e punuar pranë makinës;
- të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse sipas rregullave dhe standardeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për kryerjen e punimeve në dru me mjete të mekanizuara dhe makina përkatëse.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi kryen punime me mjete të mekanizuara të dorës, si sharra, zdrukthe, trapano, frezë dhe zumparuese.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të sharrojë, shkurtojë materialin me sharra të ndryshme të mekanizuara të dorës, sipas shënimit;
- të kontrollojë sharrimet sipas shënimit;
- të zdrukthtojë materialin me zdrukthe të mekanizuara të dorës, sipas shënimit;
- të drejtojë materialin në faqe dhe në brinjë sipas shënimit me zdrukthe të ndryshme të mekanizuara të dorës;
- të kontrollojë sipas skicës materialet e zdrukthtuara;
- të zumparojë me pajisje të mekanizuar dore me shirit, të sheshtë, të rrumbullakët sipas shkallës të pastërtisë;
- të kontrollojë me kujdes zumparimet e bëra;
- të shpojë materialin sipas shënimit;
- të pastrojë me kujdes mbeturinat e ashklave.
- të kontrollojë foletë e realizuara sipas përmasave në skicë;
- të hapë kanale me frezë të mekanizuar dore, sipas shënimit.
- të realizojë profilim të detalit me frezë të mekanizuar dore sipas skicës.
- të shkallëzojë materialin me frezë të mekanizuar dore sipas modelit.
- të kontrollojë me kujdes frezimet e bëra;
- të realizojë mbërthime dhe vidime në materialin drunor.
- të ngjitë teni, rimeso, plastikë sipas kërkesës, në brinjë me pajisje të mekanizuar të dorës.
- të pastrojë me kujdes tepricat e tenisë.
- të mbërthejë me grafitë elementet prej druri.
- të kontrollojë me kujdes punimet e bëra;

- të mirëmbajë pajisjet e mekanizuara të dorës, mjetet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi kryen punime me makinat bazë të përpunimit të drurit si sharrë shirit, disk, plan , grosetë.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të sharrojë materialin me makinë sharrë shirit sipas shënimit;
- të shkurtojë materialin me makinë sharrë disk sipas shënimit;
- të kontrollojë sharrimet sipas shënimit;
- të kontrollojë materialet e sharruara me makina sipas skicës;
- të drejtojë materialin në siperfaqe, sipas kërkesës në makinën plan drejtuese;
- të drejtojë materialin në brinjë sipas kerkesës në makinën plan drejtuese;
- të kontrollojë me kujdes saktësinë e drejtimit;
- të realizojë sipas skicë trashësinë e materialit në makinën grosecë;
- të kontrollojë me kujdes nxjerrjen e trashësisë;
- të mirëmbajë me kujdes instrumentat, makinat, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës, me makinat bazë të përpunimit të drurit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi kryen punime me makinat e shpimit, frezimit dhe thithëzimit**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të shpojë me kujdes elementet në makinë me shumë punto;
- të realizojë shpimet vertikale në pllaka, në makinë me shumë punto;
- të realizojë shpimet horizontale në pllaka, në makinë me shumë punto;
- të kontrollojë sipas modelit shpimet e bëra;
- të bëjë profilimin e elementeve sipas modelit në makinat frezë;
- të realizojë bërjen e thithave për lidhje;
- të hapë kanalet sipas përmasave në skicë;

- të realizojë shkallëzimet e elementeve sipas modelit në makinat frezë;
- të realizojë bastunet sipas diametrit në skicë;
- të hapë fole me freze zinxhir sipas modelit;
- të realizojë kopjimin e elementeve me freze kopjuese sipas modelit;
- të shkurtojë elementet me përmasa fikse në makinat sharrë;
- të realizojë supet e thithit sipas skicës;
- të zbulojë me kujdes thithin;
- të realizojë foletë në kokat e elementeve;
- të punojë elementet në makinën e thithëzimit njëanësore dhe dyanësore sipas skicës;
- të kontrollojë punimet e bëra bëra me mjete kontrolli sipas skicës apo modelit;
- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe makinat;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet me makinat e shpimit, frezimit dhe thithëzimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi kryen punime me makinat e avancuara të përpunimit të drurit.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të ndjekë përgatitjen e makinës frezë kopjuese CNC.(makinë kontroll numerik) për punë sipas normave;
- të ndjekë programimin e makinës CNC. sipas procesit të punës;
- të ndjekë lëshimin e makinës CNC. për të kontrolluar programimin;
- të punojë pllakat apo detalet në makinën CNC: sipas modelit;
- të ndjekë programimin e makinës skuadruese sipas përmasave në skicë;
- të ndjekë lëshimin e makinës skuadruese për të kontrolluar programimin;
- të skuadrojë pllakat apo detalet, sipas modelit, në makinë;
- të ndjekë gradimin e grupeve të punës në makinën
- të ndjekë gradimin e grupeve të punës në makinën borduese sipas materialit bordues;
- të ndjekë programimin e makinës borduese sipas procesit të punës;
- të ndjekë lëshimin e makinës borduese për të kontrolluar programimin;
- të veshi me bordurë pllakat apo detalet sipas modelit;
- të ndjekë gradimin e makinës sipas llojit të aksesorit metalik që do montojë;

| | |
|---|---|
| | – të ndjekë lëshimin e makinës për të kontrolluar programimin;<br>– të montojë sipas modelit aksesorin metalik;<br>– të kontrollojë punimet e bëra me makinat e avancuara të përpunimit të drurit;<br>– Të kujdeset për makinat e avancuara të përpunimit të drurit, paisjet dhe mjetet e punës;<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes të proceseve të punës me makinat e avancuara të përpunimit të drurit.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat. profesionale të përpunim drurit(zdrukthari)<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve me, me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, të punimeve me , me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e punimeve me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e punimeve me me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Mjete të mekanizuara të dorës, makinat bazë të përpunimit të drurit, makina të avancuara të përpunimit të drurit si makina shpimi, frezimi, thithëzimi, kalibrimi, skuadrimi etj.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme |

| | |
|---|---|
| | për punime me mjete të mekanizuara të dorës, makina bazë, makina të avancuara si makina të frezimit, thithëzimit, shpimit, kalibrimit, skuadrimit etj.<br>– Skica të llojeve të punimeve.<br>– Lëndë e parë.<br>– Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. |





## 2. Moduli “Punimi i dritares dhe derës prej druri ”

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri/tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| | | |
|---|---|---|
| | *PERSHKUESII I MODULIT* | |
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIMI I DRITARES DHE DERËS PREJ DRURI** | **M-09-1546-23** |
| **Qellimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime për prodhimin e dritares dhe derës prej druri masiv. | |
| **Kohezgjatja e modulit** | 84 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi përgatit vendin e punës**<br>***Kriteret e vlerësimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të organizojë vendin e punës për prodhimin e dritares dhe derës prej druri mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;<br>– të bëjë skicën me përmasa fikse, duke u bazuar te modeli dhe matjet që ka bërë në ambjentin ku do vendoset dritarja dhe dera prej druri;<br>– të zbërthejë skicën e dritares dhe derës në elementet përbërëse, sipas radhës së montimit;<br>– të përzgjedhë materialin e nevojshëm, sipas standardit dhe modelit të skicës, të dritares dhe derës prej druri;<br>– të përcaktojë veglat, pajisjet dhe makinat sipas proceseve të punës;<br>– të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;<br>– të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për prodhimin e dritares dhe derës prej druri;<br>– të kontrollojë gatishmërinë e instrumentit për punë sipas procesit dhe cilësisë në skicë;<br>– të kontrollojë funksionimin e makinës për të evidentuar defekte mekanike dhe elektrike sipas manualit;<br>– të regjistrojë makinën për punë, duke e pajisur me shabllonet përkatëse sipas proceseve;<br>– të vendosë me kujdes, materialin e punuar pranë makinës;<br>– të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse sipas |

rregullave dhe standardeve;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e dritares, derës prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi punon elementet për dritare dhe derë druri në makina**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të matë dhe të shënojë mbi material sipas përmasave të kërkuara për prodhimin e dritares dhe derës prej druri;
- të shkurtojë materialin me mbishtesat e kërkuara në makinat e shkurimit;
- të drejtojë materialin e shkurtuar në brinjë në makinën plan;
- të sharrojë materialin në gjatësi në makinën sharrë shirit apo disk me mbishtesat e nevojshme;
- të bëjë drejtimin e elementeve në faqe dhe brinjë në makinën plan –drejtues;
- të realizojë trashësinë e elementeve të dritares dhe derës sipas skicës në grosecë;
- të shkurtojë në përmasat fikse elementët e dritares dhe derës ne makinën shkurtuese universale
- të ndajë dhe të bëjë shënime te elementët, për shpimin dhe thithëzimin e tyre
- të birojë elementët me makina shpimi me shumë punto ose frezë me zinxhir sipas përmasave në skicë;
- të bëjë thithëzimin e elementeve të dritares duke u pershtatur foleve në makinat sharrë disk, frezë thithëzimi;
- të përgatitë zemrën e derës sipas modelit;
- të bëjë profilimin dhe paturën në elementet e dritares dhe derës me makinën frezë;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve, të dritares, derës prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi monton dritaren dhe derën prej druri.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të bëjë montimin paraprak të elementeve të dritares dhe derës për të evidentuar gabimet;
- të korrigjojë gabimet në se do ketë;
- të lyejë me bojë ose llak sipas kërkesës kornizën, zemrën e derës;
- të montojë me lëndë ngjitëse elementet e dritares, kasës së

derës;
- të shtrëngojë me morseta dhe të vejë në skuadër kanatet, dhe kasën;
- të fshijë lëndën ngjitëse të tepërt nga kanatet dhe kasa ;
- të zumparojë kanatet dhe kasën e dritares, derën spas shkallës të pastërtisë ;
- të vendosi menteshat në kanate dhe në kasë sipas skicës;
- të vendosi dorezat në kanatet e dritares sipas modelit;
- të lyejë dritaren dhe derën sipas kërkesës me vaj lini dhe më pas me poliuretan;
- të montojë dritaren në hapësirën e matur më parë me saktësinë e kërkuar;
- të vendosë xhamat në kanatet e dritares sipas modelit;
- të vendosë ose montojë derën në hapësirën e matur më parë;
- të vendosë dorezat në kanatet e derës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mjedisit gjatë punimeve për montimin e dritares dhe derës prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e dritares dhe derës prej druri.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e dritares dhe derës prej druri;
- të përcaktojë koston në punimin e dritares dhe derës prej druri;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston per materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- amortizim pajisjesh, etj.); të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji,
- të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri gjatë prodhimit të dritares derës prej druri druri;
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e dritares dhe derës prej druri;
- Përgatitja e faturës, për koston e dritares, derës prej druri;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të njohë marketingun e dritares dhe derës prej druri (studimi i tregut të shitjes).

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit si dhe në ambjentin ku do montohet përfundimisht dritarja dhe dera prej druri.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve per prodhimin e dritares dhe derës prej druri.<br>– Mësuesi i praktikës mund të organizojë edhe vizita në objekte ndërtimi ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për prodhimet e dritares dhe derës prej druri.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të prodhimit të dritares dhe derës prej druri.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për punime druri.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të përpunuesit të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Materiale të ndryshme drusore për prodhim te dritares dhe derës prej druri dhe materiale ndihmëse për prodhim.<br>– Skica e dritares dhe derës prej druri.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## 3. Moduli “Punime veshje me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme”

**Drejtimi: Përpunim druri**
**Profili: Mobileri/tapiceri**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli** | **PUNIME VESHJE ME TAPICERI TË SIPËRFAQEVE TE NDRYSHME** | **(M-09-419-19)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime të veshjes me tapiceri të sipërfaqeve të ndryshme si muri, tavani, dere, banaku etj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |

**Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit**

**RN 1** **Nxënësi organizon vendin e punës për punime veshje me tapiceri të sipërfaqes.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të skicojë sipërfaqen që do vishet me tapiceri;
- të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;
- të përzgjedhë, sipas modelit, materialet për veshjen me tapiceri të sipërfaqes;
- të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;
- të përgatisë sipas kërkesës veglat pajisjet dhe makinat për veshjen e sipërfaqes me tapiceri;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes të sipërfaqes me tapiceri;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2** **Nxënësi përgatit sipërfaqen prej pllake ose telajo.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë, sipas skicës, mbi material për veshjen e sipërfaqes me tapiceri;
- të sharrojë sipas shënimit mbi pllakën e fibrës ose kompensatës për veshjen e sipërfaqes me tapiceri;
- të sharrojë sipas përmasave në skicë.
- të shkurtojë materialin sipas përmasës;

- të drejtojë materialin sipas trashësisë të kërkuar;
- të punojë në makinën grosecë sipas trashësisë të kërkuar;
- të presë sipas skicës me masa fikse traversat e telajos;
- të montojë elementet për formimin e telajos;
- të zbatoje me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes te mjedisit gjatë veshjes të siperfaqeve me tapiceri;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi kryen punime për veshjen me tapiceri të sipërfaqes.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të presë sfungjerin sipas përmasës në skicë;
- të presë mbulesën sipas përmasës në skicë;
- të lyejë sfungjerin me lëndë ngjitëse sipas normativës;
- të vendosi sfungjerin, me kujdes, në sipërfaqen e caktuar;
- të vendosi mbulesën me igelit, damaskë sipas kërkesës;
- të mbërthejë mbulesën sipas preventivit me thumba tapicerie etj;
- të kontrollojë cilsisinë sipas standartit;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes të sipërfaqeve të ndryshme me tapiceri;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për veshjen me tapiceri të sipërfaqes.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike për procesin e veshjes me tapiceri të sipërfaqes;
- të përcaktojë koston ne punimin e veshjes me tapiceri të sipërfaqes;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël Mobileri dhe tapiceri gjatë procesit të veshjes me tapiceri të sipërfaqes;
- të hartojë preventivin përfundimtar për procesin e veshjes me tapiceri të sipërfaqes;
- përgatitja e faturës, për procesin e veshjes me tapiceri.

| | |
|---|---|
| | të sipërfaqes;<br>– të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;<br>– të studiojë marketingun e procesit të veshjes me tapiceri të sipërfaqes(studimi i tregut të shitjes,përcaktimi i cmimit, mënyrën e shperndarjes së produktit, reklamën);<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose të organizohen vizita mësimore në punishte reparte,ndërrmarje ku prodhohen objekte druri të tapicuara.<br>– Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimeve të drejta të veglave dhe pajisjeve si dhe të përgatitjes së materialeve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për prodhimin e mobiljeve të tapicuara.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Per realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për punime tapicerie.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Materiale të ndryshme drusore për veshje me tapiceri.<br>– Materiale ndihmëse tapicerie, për veshje të sipërfaqeve.<br>– Skica të sipërfaqes që do vishet me tapiceri.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhezuesa,<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## 4. Moduli "Punime montimi të objekteve prej druri"

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME MONTIMI TË OBJEKTEVE PREJ DRURI** | **(M-09-420-23)** |
| **Qellimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime montimi të objekteve prej druri me elemente të drejta, pllakë zdrukthi, fibre. | |
| **Kohezgjatja e modulit** | 66 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor "Përpunim druri". | |

**Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit**

**RN 1** **Nxënësi përgatit vendin e punës.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për montimin e objektit të drurit në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;
- të zbërthejë skicën e objektit në elementët përbërës;
- të përcaktojë saktë rradhën e montimit të detaleve sipas modelit dhe skicës;
- të përzgjedhë saktë elementet prej druri, pllakat me bazë druri të përgatitura dhe lëndët ndihnëse.
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për montimin e objektit të drurit;
- të zbatojë drejtë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për montimin e objektit të drurit me elementë të drejtë;

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2** **Nxënësi monton objekte të thjeshta në mënyrë artizanale**.

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë e shënojë mbi elementet e përgatitura sipas skicës;
- të bejë shpime dhe të hapi fole me pajisjet e nevojshme për shpim;
- të përgatisë kunjat bashkues sipas përmasave në skicë ;
- të veshë brinjët e pllakave të prera me teni, rimeso, plastikë, duroalumin apo dru masiv;
- të vendosë aksesorët metalikë dhë plastikë sipas modelit;

- të montojë paraprakisht objektin, pa lëndë ngjitëse, për kontroll;
- të eleminojë defektet në rast se do ketë;
- të ndërtojë skeletin e objektit;
- të bëjë montime plotësuese sipas skicës;
- të përgatisë sirtaret në rast se ka modeli;
- të vendosë aksesorët plotësues sipas skicës;
- të përgatitë lëndën ngjitëse sipas recetës ;
- të aplikojë lëndën ngjitësë në vëndin e caktuar të detalit ;
- të montojë perfundimisht objektin;
- të kryejë pastrimin e nevojshëm të mbeturinave të lëndës ngjitëse
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të objektit të drurit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3** **Nxënësi monton kuzhinë të thjeshtë (bufe k bufe) në objekt**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë e të shënojë mbi elementet e përgatitura sipas skicës;
- të bëjë shpime dhe të hapi fole me pajisjet e nevojshme për shpim;
- të veshë brinjët e pllakave të prera me teni, rimeso, plastik, duralumin apo druri;
- të përgatisë kunjat bashkues sipas përmasave në skicë ;
- të vendosë aksesorët metalikë apo plastikë sipas modelit;
- të montojë paraprakisht objektin pa lëndë ngjitëse për kontroll të defekteve;
- të eleminojë defektet në rast se do ketë;
- të ndërtojë skeletin e mobiljes;
- të bëjë montime plotësuese sipas skicës;
- të përgatisë sirtaret në rast se ka modeli;
- të vendosë aksesorët plotësues sipas skicës;
- Të përgatitë lëndën ngjitëse sipas recetës ;
- Të aplikojë lëndën ngjitësë në vëndin e caktuar të detalit ;
- të montojë perfundimisht mobiljen;
- të kryejë pastrimin e nevojshëm të mbeturinave të lëndës ngjitëse
- të amballazhojë me kujdes pjesët e bufesë për të evituar dëmtimet gjatë transportit për në vendin e instalimit;
- të transportojë me kujdes pjesët e bufesë;
- të vendosë me kujdes pjesën e poshtëme të bufesë në vendin e matur më parë sipas skicës;
- të vendosë suprinën apo banakun me ngjyrën e kërkuar nga klienti;
- të vendosë alzatrinën;

- të vëndosë xokolën;
- të vendosë pjesën e sipërme të kundra- bufesë në vëndin e matur më parë sipas kerkesës;
- të vendosë lavapjatën, pjanurën ,furrën, aspiratorin, frigoriferin sipas modelit dhe skicës;
- të vendosë dorezat sipas kërkesës të klientit;
- të bëjë regjistrimin e kanateve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të bufesë së thjeshtë për guzhinë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi kryen punime të thjeshta pirografie dhe gdhëndje (dekorimi) në detalet e mobiljeve**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me daltë gdhëndjen sipas vizatimit të kërkuar;
- të zumparojë mbas gdhëndjes detalin;
- të kryejë pastrimin nga pluhuri i drurit me solucione përkatëse;
- të kontrollojë cilësinë e gdhëndjes sipas modelit;
- të përdorë aparatin e thjeshtë të pirografisë;
- të kryejë pirografi mbi detalet sipas modelit;
- të pastrojë detalet pas pirografisë
- të kontrollojë cilësinë e pirografisë së kryer;
- të kurjdeset për mjetet dhe pajijet e punës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të bufesë së thjeshtë për guzhinë

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për** punime montimi të objekteve prej druri

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike në punime montimi të objekteve prej druri;
- të përcaktojë koston në punime montimi të objekteve prej druri;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj.);
- të përcaktojë kosto te tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;

| | |
|---|---|
| | – të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri në punime montimi të objekteve prej druri;<br>– të hartojë preventivin përfundimtar për punime montimi të objekteve prej druri;<br>– të përgatisë faturën, për punime montimi të objekteve prej druri;<br>– të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;<br>– të njohë marketingun për punime montimi të objekteve prej druri; (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën);<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës, në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit si dhe në ambientet e aredimit si banesa lokale etj..<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve per montimin e objekteve të drurit me elementë të drejtë, me pllakë zdrukthi, fibre.<br>– Mësuesi i praktikës mund të organizojë edhe vizita në objekte druri ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për montimin e objekteve të drurit me elementë të drejtë me pllakë zdrukthi, fibre.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të montimit të mobiljeve me pllakë zdrukthi, fibër, entief, në mënyrë të pavarur dhe në grupe.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për montim të mobiljeve, ambiente aredimi.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të përpunuesit të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Detale dhe pllaka drusore të punuara ne makina, për montimin e mobiljeve me elementë të drejtë, me pllakë zdrukthi, fibër dhe materiale ndihmëse.<br>– Materiale për paketimin e pjesëve të mobiljes së montuar.<br>– Skica të vëndit të aredimit<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa.<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## 5. Moduli “Punime patinimi, llustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve”

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME PATINIMI, LLUSTRIMI, RIPARIMI DHE RESTAURIMI TË MOBILJEVE** | | **(M-09-1897-23)** |
| **Qellimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të riparuar defektet gjatë ndërtimit të mobiljeve si dhe restaurimin e mobiljeve të vjetra. | | |
| **Kohezgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi përgatit vendin e punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të organizojë vendin e punës për për të kryer procese përmirsimit të drurit apo mobiljes si imitim, patinim, lustrim, riparimdhe restaurim;<br>– të përzgjedhë mënyrën e imitimit, patinimi, lustrimit të drurit;<br>– të përzgjedhë mjetin e imitimit, patinimit, llustrimit me dorë apo makinë;<br>– të kontrollojë mobiljen e vjetër për të konstatuar punimet që duhen kryer gjatë restaurimit;<br>– të përcaktojë defektet gjatë punimeve, në ngjitje, vendosje tenish, rimesim, llustrim, etj.;<br>– të përcaktojë defekte gjatë veshjes me tapiceri të skeleteve të ndryshme prej druri ose materiale të tjera;<br>– të përzgjedhë materialet e nevojshme për imitim, patinim, lustrim, riparim apo restaurim;<br>– të llogaritë sasinë e materialeve të nevojshme për imitim, patinim, lustrim, riparim apo restaurim;<br>– të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për imitim, patinim, lustrim, riparim apo restaurim;<br>– të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për imitim, patinim, lustrim, riparim apo restaurim të mobiljeve të vjetra;<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli | |

**RN 2** **Nxënësi kryen punime riparimi gjatë ndërtimit të mobiljeve dhe tapicerisë.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pastrojë brinjët e veshura me difekt nga tenia, rimesua, plastika etj., me kujdes ;
- të veshi me kujdes brinjën e pastruar me rimeso, teni, plastikë të përshtatëshme sipas standartit;
- të zumparojë atë pjesë të sipërfaqes të patinuar me defekt;
- të pastrojë sipërfaqen e zumparuar me mjetet e nevojshme;
- të kryejë ribojatisjen me kujdes, në detalin apo pllakaën duke mos ndryshuar ngjyrën;
- të ripatinojë detalin apo sipërfaqen e pllakës sipas kërkesës;
- të zumparojë sipërfaqen nga lustrimi me difekt.
- të pastrojë sipërfaqen e zumparuar me mjetet e caktuara;
- të rilustrojë detalet apo pllakat mbas pastrimit;
- të riparojë defekte të ndryshme gjatë punimeve në tapiceri të skeleteve prej druri, metali apo plasike, si vendosje, gabim të sustave, sfungjerit, veshje damaske etj, ;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të defekteve në ndërtimin e mobiljeve dhe tapicerisë;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2** **Nxënësi kryen procese imitimi, patinimi dhe llustrimi me pllaka dhe detale prej druri.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë sipërfaqen e pllakës për imitim
- të përgatitë materialin imitues;
- të kryejë procese të imitimit të drurit mbi pllakë sipas modelit me pajisje dore;
- të kryejë procese të imitimit të drurit me makinat përkatëse;
- të përgatitë sipërfaqen e pllakës, detalit prej druri për patinimim;
- të përgatitë materialin patinues sipas recetës përkatëse;
- të kryejë procese të patinimit me dorë, pajisje dore;
- të kryejë procese patinimi me makina sipas standartit;
- të kryejë procese të tharjes së pastës patinuese në paisje tharëse sipas rregjimit;
- të kontrollojë cilësinë e patinimit sipas shkallës së pastërtisë;
- të përgatitë lëndën për lyerje apo llustrim të drurit sipas standartit
- të lyejë apo llustrojë me pajisje splucimi, me makinë

pllakat, detalet prej druri sipas kërkesës;
- të kryejë procesin e tharjes së bojës ose lëndës llustruese sipas rregjimit të caktuar;
- të kontrollojë cilësinë e llustrimit sipas standartit;
- të kryejë pastime dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe makinave;
- të ndjekë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit, gjatë proceseve të imitimit, patinimit dhe lustrimit të pllakave dhe detaleve prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi kryen punime riparimi gjatë ndërtimit të mobiljeve dhe tapicerisë.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të pastrojë brinjët e veshura me difekt nga tenia, rimesua, plastika etj., me kujdes ;
- të veshi me kujdes brinjën e pastruar me rimeso, teni, plastikë të përshtatëshme sipas standartit;
- të zumparojë atë pjesë të sipërfaqes të patinuar me defekt;
- të pastrojë sipërfaqen e zumparuar me mjetet e nevojshme;
- të kryejë ribojatisjen me kujdes, në detalin apo pllakaën duke mos ndryshuar ngjyrën;
- të ripatinojë detalin apo sipërfaqen e pllakës sipas kërkesës;
- të zumparojë sipërfaqen nga lustrimi me difekt.
- të pastrojë sipërfaqen e zumparuar me mjetet e caktuara;
- të rilustrojë detalet apo pllakat mbas pastrimit;
- të riparojë defekte të ndryshme gjatë punimeve në tapiceri të skeleteve prej druri, metali apo plasike, si vendosje, gabim të sustave, sfungjerit, veshje damaske etj.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të defekteve në ndërtimin e mobiljeve dhe tapicerisë;

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi kryen punime për restaurimin e mobiljeve të vjetra.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatitë sipërfaqen për lusrim
- të pastrojë mobiljen e vjetër, me ujë të vakët nga papastërtitë;
- të zbërthejë mobiljen në pjesët përbërse, në se nevoitet;
- të eleminojë elementët e dëmtuara nga lagështia, insektet, kërpudhat etj;
- të trajtojë pjesët e mobiljes me antiseptikë, për frenimin e

dëmtimeve, nga insektet apo kërpudhave;
- të zumparojë elementët për pastrim;
- të zëvëndësojë elementet e dëmtuara nga lagështira apo prekje kërpudha, detale apo rimeso etj.;
- të ngjitë rimeson e re ku është e nevojshme;
- Të përgatisë bojën për lyerje sipas kërkesës;
- të kryejë punime lyerje, me bojë, për tu përshtatur bojës ekzistue;
- të thajë pjesët e lyera me bojë në mënyrë natyrore apo paisje sipas kërkesës;
- të përgatitë materialet për llustrim;
- të llustrojë me lëndë llustruese gomollatë apo poliuretan sipas standartit;
- të thajë shtresën e llustrës në mënyrë naturore apo paisje të posaçme;
- të pastrojë sipërfaqen e llustruar me kujdes;
- të kryejë montimet e nevojshme sipas modelit;
- të ndjekë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit, gjatë restaurimit të mobiljeve të vjetra prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 5** **Nxënësi kryen llogaritje te thjeshta ekonomike në punime patinimi, llustrimi, riparimi apo restaurimi të mobiljes.**

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike në punime në punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes;
- të përcaktojë koston në punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri në punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes;
- të hartojë preventivin përfundimtar për punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes;
- të përgatisë faturën, për punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;

| | |
|---|---|
| | – të zbatojë parimet e marketingut për punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljes (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën).<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të kryerjes së punimeve patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve të përdorura antike;<br>– Mësuesi i praktikës mund të organizojë edhe vizita në punishte të prodhimit të mobiljeve ku nxënësit të shohin konkretisht punime patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve të vjetra;<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete, të punimeve patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve të vjetra.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për punime të kryerjes së punimeve patinimi, lustrimi, riparimi dhe restaurimi të mobiljeve të vjetra;<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve për patinim, lustrim, riparim të defekteve dhe restaurim të mobiljeve të vjetra;<br>– Detale, pllaka prej druri që do patinohen, lustrohen, skelete të tapicuara që do riparohen, mobilje e vjetër për restaurim etj.<br>– Materiale ndihmëse për patinim, lustrim, riparim dhe restaurim.<br>– Modele të patinuara, lustruara, riparuara dhe të restauruara.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## 6. Moduli “Punimi i mobiljes së tapicuar në skelete të ndryshme”

**Drejtimi: Përpunim druri**
**Profili: Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIMI I MOBILJES SË TAPICUAR NË SKELETE TË NDRYSHME** | **(M-09-1548-19)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime për një mobilje të tapicuar si karrige, kolltuk, divan të thjeshtë etj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi organizon vendin e punës për punime tapicerie në skelete të ndryshme të mobiljes të tapicuar**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të analizojë skicën e skeletit që do vishet me tapiceri;<br>– të zbërthejë skicën sipas rradhës në elementët përbërës;<br>– organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;<br>– të përzgjedhë, sipas modelit, materialet për veshjen me tapiceri të skeletit përkatës;<br>– të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;<br>– të përgatisë sipas kërkesës veglat pajisjet dhe makinat për veshjen e skeletit me tapiceri;<br>– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veshjes së skeletit me tapiceri.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| | **RN 2** | **Nxënësi kryen punimin e skeletit prej druri, fibre, kompensate.**<br>***Kriteret e vlerësimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të matë dhe shënojë sipas skicës mbi material për punimin e skeletit të mobiljes që do vishet me tapiceri;<br>– të sharrojë sipas shënimit mbi pllakën e fibrës ose kompensatës për kolltukun, divanin, karrigen e tapicuar; |

- të sharrojë sipas përmasave në skicë, materialin drunor;
- të shkurtojë materialin sipas përmasës;
- të drejtojë materialin sipas trashësisë të kërkuar;
- të punojë në makinën grosecë sipas trashësisë të kërkuar;
- të presë sipas skicës me masa fikse detalet;
- të përgatisë shpinën apo mbështetësen;
- të përgatisë krahët;
- të përgatisë kllapat sipas skicës;
- të përgatisë këmbët sipas skicës;
- të zumparojë këmbët sipas shkallës të pastërtisë;
- të lyejë këmbët sipas kërkesës me bojë ose llak;
- të montojë elementet për formimin e ndenjeses;
- të zbatoje me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes te mjedisit gjatë punimit të skeletit sipas modelit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi vesh me tapiceri skeletin.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të presë sfungjerin sipas përmasës në skicë;
- të presë mbulesën sipas përmasës në skicë;
- të lyejë sfungjerin me lëndë ngjitëse sipas normativës;
- të vendosë sfungjerin, me kujdes, në skeletin e mobiljes në ndenjëse, në mbështetëse, në krah;
- të vendosi mbulesën me igelit, damaskë sipas kërkesës;
- të mbërthejë mbulesën sipas preventivit me thumba tapicerie etj.;
- të montojë këmbët sipas skicës;
- të kontrollojë cilsisinë sipas standartit;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë veshjes së skeletit me tapiceri dhe përfundimit të mobiljes së tapicuar.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi kryen llogaritje te thjeshta ekonomike për prodhimin e mobiljes të tapicuar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e mobiljes së tapicuar;
- të përcaktojë koston në punimin e mobiljes së tapicuar;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji,

| | |
|---|---|
| | amortizim pajisjesh, etj.);<br>– të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit “Mobileri dhe tapiceri”;<br>– të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri gjatë prodhimit të mobiljes së tapicuar;<br>– të hartojë preventivin përfundimtar për prodhimin e mobiljes së tapicuar;<br>– të përgatitë faturën, për koston e mobiljes së tapicuar;<br>– të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;<br>– të njohë marketingun e mobiljes së tapicuar (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën).<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer punime për një mobilje të tapicuar si karrige, kolltuk, divan të thjeshtë etj.<br>– Mësuesi i praktikës mund të organizojë edhe vizita në punishte të prodhimit të mobiljeve ku nxënësit të shohin konkretisht punime të tapicuara si karrige, kolltuk, divan të thjeshtë etj.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen për të kryer punime për një mobilje të tapicuar si karrige, kolltuk, divan të thjeshtë etj.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për punime druri.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të përpunuesit të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Materiale të ndryshme drusore për punimin e mobiljes së tapicuar.<br>– Materiale ndihmëse për punimin e mobiljes së tapicuar.<br>– Skica të mobiljes së tapicuar.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Punime për përkuljen e drurit”

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME PËR PËRKULJEN E DRURIT** | | **(M-09-1898-23)** |
| **Qellimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime për detalet e përkulura prej druri. | | |
| **Kohezgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi përgatit vendin e punës**<br>***Kriteret e vlerësimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart për realizimin e detaleve të përkulura prej druri;<br>– të skicojë detalin që do përkulet sipas modelit të kërkuar;<br>– të zbërthejë skicën e detalit të përkulur prej druri;<br>– të përzgjedhë materialet e nevojshme për prodhimin e detaleve të përkulura prej druri;<br>– të zgjedhë veglat, pajisjet dhe makinat për prodhimin e detaleve të përkulura prej druri;<br>– të përzgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;<br>– të përcaktojë rradhën e punës sipas procesit teknologjik të përkuljes së detaleve;<br>– të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik.<br>– të kontrollojë gatishmërinë e pajisjeve të nevojshme për punë sipas procesit dhe cilësisë në skicë;<br>– të kontrollojë funksionimin e makinës për të evidentuar defekte mekanike dhe elektrike sipas manualit<br>– të vendosë me kujdes, materialin e punuar pranë makinës;<br>– të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse sipas rregullave dhe standardeve;<br>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së | |

mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e detaleve të përkulura prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi kryen punime për përkuljen e drurit pa trajtim paraprak**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe të shënojë mbi materialin drunor, që do përkulet pa trajtim paraprak;
- të sharrojë materialin sipas përmasave në skicë;
- të shkurtojë materialin drunor, apo fletë kompensate sipas kërkesës, me kujdes;
- të bëjë drejtimin e materialit në faqe dhe brinjë në makinën plan;
- të realizojë trashësinë e detaleve sipas skicës në grosecë;
- të bashkojë shtresat e kompensatës sipas kërkesës në skicë p.sh. për ndënjëse karrige;
- të sigurohet që materiali të ketë lagështirën e kërkuar për përkulje;
- të thajë detalet mbas përkujes;
- të zbërthejë detalet e përkulura nga kallëpet;
- të kryejë profilimin e detaleve sipas modelit në makinën freze;
- të shkurtojë në përmasat fikse detalet e përkulura sipas skicës;
- të lyejë me bojë ose llak detalet e përkulura sipas kërkesës;
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas standarti;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes së detalet e përkulura prej druri pa avullim

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi kryen punime për përkuljen e drurit me avullim**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe të shënojë mbi materialin drunor që do për kulet sipas skicës;
- të sharrojë materialin sipas shënimeve;
- të shkurtojë materialin me kujdes;
- të bëjë drejtimin e materialit në faqe dhe brinjë në makinën plan;
- të realizojë trashësinë e detaleve sipas skicës në grosecë;
- të vendosë materialin në kallëpë të posacëm, me fiksimin e nevojshëm;
- të vendosë kallëpet me materialin drunor në paisjet e

avullimit;
- të ndjekjë rregjimin e trajtimit termik me avull të detaleve;
- të thajë detalet e përkulura;
- të largojë detalet nga kallëpet;
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas standartit.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përkuljes së materialit drunor me trajtim termik me avull;

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi kryen punime për realizimin e parmakëve për shkallë helikoidale**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të matë dhe të shënojë mbi materialet  për realizimin e parmakëve për shkallë elikoidalë;
- të sharrojë materialin  sipas përmasave në skicë ;
- të shkurtojë materialin me kujdes ;
- të bëjë drejtimin e materialit në faqe dhe brinjë në makinën plan;
- të realizojë trashësinë e materialit drunor, sipas skicës në grosecë;
- të kryejë përkuljen e detaleve për realizimin e shkallëve helikoidale me metodën e kërkuar;
- të bëjë profilimin e detaleve të kornizës sipas modelit në makinën freze;
- të shkurtojë në përmasat fikse elementet përbërëse të parmakut helikoidal sipas skicës;
- të realizoje lidhjet e detaleve përbërëse së parmakut të shkallëve helikoidale, të presë me kënd, etj. në makinat përkatëse;
- të lyejë me bojë ose llak  me kujdes elementët përbërës së parmakut të shkallëve elikoidale;
- të montojë me kujdes elementet përbërëse për formimin e parmakut të shkallëvë helikoidale;
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas standartit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë  montimit të elementeve përbërëse për formimin e parmakut të shkallëvë helikoidale.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për punime të detaleveve të përkulura prej druri**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike për punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidale, karrige, krahë kolltuku etj.;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqerore etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri, për punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidale, karrige, krahë kolltuku etj.;
- të hartojë preventivin përfundimtar për punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidale, karrige, krahë kolltuku etj.;
- të përgatisë faturën, për koston e punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidalë, karrige, krahë kolltuku etj.;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të njohë marketingun e detaleve të përkulura prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidalë, karrige, krahë kolltuku etj.; (studimi i tregut të shitjes,përcaktimi i cmimit,mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën);

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave për punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri helikoidale, karrige, krahë kolltuku etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje dhe prerje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punime të përkuljes së detaleve prej druri për objekte të ndryshme si parmakë për shkallë druri

| | |
|---|---|
| | helikoidale, karrige, krahë kolltuku etj.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prerjen e lëndës së parë.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime druri.<br>– Lëndë e parë drunore.<br>– Skica të objekteve të ndryshme me detale të përkulura prej druri .<br>– Paisje për avullimin e materialit drunor që do përkulet.<br>– Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. |

**2. Moduli “Punime për prodhimin e mobiljeve në linja zinxhir”**

**Drejtimi: Përpunim druri**
**Profili: Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli: II**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli** | **PUNIME PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE NË LINJA ZINXHIR** | **(M-09-1899-23)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të punuar mobilje në linja zinxhir. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi organizon vendin e punës për punimin e mobiljes në linja zinxhir.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të mobiljes që do prodhojë;<br>– të zbërthejë vizatimin në elementët përbërës;<br>– të përcaktojë rradhën e punës sipas procesit teknollogjik të caktuar;<br>– të përzgjedhë materialin kryesor si pllaka të ndryshme zdrukthi, fibre me bazë druri, të nevojshëm sipas standartit;<br>– të përzgjedhë materialet ndihmëse si lëndë ngjitëse, llustruese, aksesorë të ndryshëm, mjete për paketim etj;<br>– të përcaktojë veglat pajisjet dhe makinat sipas proceseve të punës zinxhir;<br>– të përzgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;<br>– të organizojë vëndin e punës në mënyrë ergonomoke, sipas kushteve në fabrikë, repart;<br>– të sistemojë materialet e papërpunuara në vendin e punës sipas procesit teknologjik, të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit;<br>– të përzgjedhë instrumentat përkatëse sipas mjeteve të mekanizuara të dorës dhe makinave;<br>– të montojë me saktësi instrumentin në makinën përkatëse sipas manualit;<br>– të kontrollojë gatishmërinë e instrumentit për punë sipas |

procesit dhe cilësisë në skicë;
- të kontrollojë funksionimin e makinës për të evidentuar defekte mekanike dhe elektrike sipas manualit;
- të regjistrojë makinën për punë, duke e pajisur me shabllonet përkatëse sipas proceseve;
- të kontrollojë saktësinë e regjistrimit dhe të punimit në makineri sipas procesit;
- të kontrollojë funksionimin e pajisjeve dhe makinave të lyerjes me lëndë ngjitëse;
- të kontrollojë funksionimin e pajisjeve të llustrimit;
- të vendosë me kujdes, materialin e punuar pranë makinës;
- të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse sipas rregullave dhe standardeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për kryerjen e punimeve të mobiljes në linja zinxhir.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi punon mobiljen në makineri.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të matë dhe shënojë sipas skicës mbi material për prodhimin e mobiljes në linjë zinxhir;
- të sharrojë sipas shënimit mbi pllakën me bazë druri për një element të caktuar si fjanke, dyer,shpina, balle sirtarësh etj.
- të shkurtojë sipas shënimit mbi pllakën me bazë druri për një element të caktuar si fjanke, dyer, balle sirtarësh etj.
- të punojë në makinën e skuadrimit, formatizimit elementët, pllakë apo detale, me toleranca dhe azhustazhe që lejojnë ndërkëmbim
- të kryejë proceset e thithezimit në makinat përkatëse me toleranca dhe azhustazhe që lejojnë ndërkëmbim;
- të kryejë proceset e birimit në makinat përkatëse me toleranca dhe azhustazhe që lejojnë ndërkëmbim;
- të transportojë elementët e punuar në sektorë të tjerë me vagonetë, me transportierë.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimit në makineri të elementeve të mobiljes në linja zinzhir.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi punon në sektorin e lyerjes me kimikate**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike për punimin e kanapesë krevat;

- të përgatitë lëndën ngjitëse sipas recetës ;
- të furnizojë makinën me lëndë ngjitëse sipas rregullave ;
- të kryejë procesin e lyerjes të elementeve me makina duke respektuar kohen e caktuar ;
- të përgatitë lëndën llustruese sipas recetës ;
- të furnizojë makinat e llustrimit me lëndën lustruese sipas standartit ;
- të kryejë procesin e lustrimit me makinat përkatëse duke respektuar kohën ;
- të kryejë pastrimin e nevojshëm të mbeturinave me kimikateve sipas shkallës së pastërtisë ;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë aplikimit të kimikateve në elementet e mobiljes së prodhuar në linja zinxhir.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi punon në sektorin e montimit**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë një grup operacione të vogla pune montimi në një post pune;
- të zbatojë me rigorozitet kohën e kryerjes së operacioneve për vazhdueshmërinë e montimit;
- të kryejë procese transportimimi të pjesëve të montuara me vagoneta të posacme;
- të kryejë procese montimi dhe transportimin me një transportier me lëvizje të ndërprerë në linja zinxhir të thjeshta duke respektuar kohën;
- të kryejë procese montimi mbi një transportier me lëvizje të vazhdueshme në linja konvejer;
- të kryejë procese montimi dhe transporti mbi transportier që ndodhet në nivelin e dyshemesë;
- të kryejë procese montimi dhe transporti mbi transportier që ndodhet në nivelin e bangove të punës;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të montimitit në linja zinxhir.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi punon në sektorin e paketimit dhe magazinimit**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë cilësinë, sipas kartës teknologjike me mjetet e kontrollit.
- të përdori materialet dhe mjetet e nevojshme për ambalazhimin, etiketimin dhe paketimin e elementeve.

– të kryejë procese të ambalazhimit dhe etiketimit me materialet dhe mjetet përkatëse sipas standardeve.
– të kryejë procese të paketimit të materialit, sipas standardeve.
– të kryejë procese të magazinimit të punimeve të kryera sipas standardit të magazinimit.
– të transportojë elementet e prodhuar sipas standardeve.
– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të paketimit dhe maganizimit, të mobiljes së prodhuar në linja zinxhir.

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 6 Nxënësi kryen llogaritje ekonomike për punime të prodhimit të mobiljeve në linja zinxhir**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

– të realizojë llogaritjet ekonomike për punime të mobiljeve në linja zinxhir;
– të përcaktojë koston në punimin e kanapesë krevat; të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
– të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj.);
– të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
– të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
– të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri gjatë punimit të mobiljeve në linja zinxhir;
– të hartojë preventivin përfundimtar për për punime të mobiljeve në linja zinxhir;
– të përgatitë faturën, për koston e punime të mobiljeve në linja zinxhir;
– të komunikojë me etikë profesionale;
– të zbatojë parimet e marketingut të produktit (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyren e shpërndarjes së produktit, reklamën).

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në reparte, ndërrmarje ku prodhohen mobilje në linja zinxhir.<br>– Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimeve të drejta të veglave dhe pajisjeve si dhe të përgatitjes së materialeve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për prodhimin e për punime të mobiljeve në linja zinxhir;<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Per realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Reparte, ndërmarje të punimeve për prodhimin e mobiljeve në linja zinxhir.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të përpunuesit të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Materiale të ndryshme drusore për prodhim të mobiljeve në linja zinxhir.<br>– Materiale ndihmëse për prodhim të mobiljeve në linja zin xhir.<br>– Skica të ndryshme të reparteve të prodhimit zinxhir<br>– Skica të mobiljeve.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhezuesa,<br>– Kompleti i veshjeve te punës. |

## 3. Moduli “Punime për shtrimin e dyshemesë me parket”

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME PËR SHTRIMIN E DYSHEMESE ME PARKET** | **(M-09-1551-19)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime për shtrimin e trarëve mbështetës si dhe për shtrimin e dyshemesë me parket. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi përgatit vendin e punës.**<br>***Kriteret e vleresimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart për shtrimin e dyshemesë me parket;<br>– të përzgjedhë saktë veglat dhe mjetet e nevojshme për punë;<br>– të kryejë saktë matjen e sipërfaqes për shtrimin e dyshemesë me parket;<br>– të llogaritë me saktësi bazën materiale të nevojshme për shtrim;<br>– të grumbullojë trarët mbështetës sipas përmasave dhe numrit të caktuar;<br>– të grumbullojë parketin sipas formës të kërkuar i drejtë, me kënd ose kurriz peshku;<br>– të transportojë me shumë kujdes trarët dhe parketin në vendin e duhur;<br>– të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe parketit;<br>Instrumentet e vlerësimit:<br>– Vëzhgim me listë kontrolli<br><br>**RN 2** **Nxënësi kryen punime për shtrimin e trarëve mbështetës.**<br>***Kriteret e vleresimit***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të matë saktë sipërfaqen e caktuar për shtrim;<br>– të llogaritë bazën materiale të nevojshme për shtrim sipas | |

madhësisë së sipërfaqes;
- të kontrollojë nivelin e traut të parë, sipas standardit;
- të nivelojë traun e fundit duke iu referuar traut të parë;
- të nivelojë trarët ndërmjetës duke iu referuar trarëve kufizues;
- të kryejë saktë fiksimin e trarëve anësor të niveluar;
- të kryejë saktë fiksimin e trarëve të ndërmjetëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për shtrimin e trarëve mbështetës.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi kryen punime për shtrimin e parketit.**

***Kriteret e vleresimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të shtrojë saktë, dyshemenë me parket sipas formës: i drejtë, me kënd, kuriz peshku;
- të fiksojë siç duhet parketin;
- të vendosë saktë kornizat anësore;
- të kryejë zumparimin e dyshemesë me parket;
- të kryejë lyerjen e dyshemesë me ngjyrues, me dyll bletësh, me llak, me poliuretan parketi, etj sipas kërkesës;
- të kujdeset për veglat e pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë shtrimit të dyshemesë me parket.

Instrumentet e vlerësimit:
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për shtrimin e dyshemesë me parket.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike në punime për shtrimin e dyshemesë me parket;
- të përcaktojë koston në punime për shtrimin e dyshemesë me parket, të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Mobileri dhe tapiceri”;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël “Mobileri dhe tapiceri” gjatë punimeve për shtrimin e dyshemesë me parket;
- të hartojë preventivin përfundimtar në punime për shtrimin e dyshemesë me parket;
- të përgatitë faturën, për koston e punimeve për

| | |
|---|---|
| | shtrimin e dyshemesë me parket;<br>– të komunikojë me etikë profesionale;<br>– të njohë Marketingun e punimeve për shtrimin e dyshemesë me parket (studimi i tregut të shitjes,përcaktimi i cmimit, mënyren e shpërndarjes së produktit, reklamën).<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari).<br>– Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të shtrimit të dyshemesë me parket.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje dhe prerje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për shtrimin e dyshemesë me parket.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e shtrimit të dyshemesë me parket.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Repart për punime druri.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të përpunuesit të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Trarë të përgatitur, parket me formë sipas modelit dhe materiale ndihmëse për shtrimin e dyshemesë me parket.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,<br>– Kompleti i veshjeve të punës. |

## 4. Moduli “Punimi i skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri”

**Drejtimi:** **Përpunim druri**
**Profili:** **Mobileri dhe tapiceri**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIMI I SKELËS SË THJESHTË DHE SHKALLËVE PREJ DRURI** | **(M-09-1552-19)** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar objekte që shërbejnë në sektorin e ndërtimit | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin e II të KSHK, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. | |

**Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit**

**RN 1** **Nxënësi përgatit vendin e punës.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për prodhimin e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri në mënyrë ergonomike, sipas kushteve në repart;
- të skicojë, skelën e thjeshtë dhe shkallët prej druri, sipas modelit;
- të zbërthejë skicën e skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri në elementët përbërës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për punimin e skelës dhe shkallëve prej druri;
- të përzgjedhë veglat pajisjet dhe makinat për punimin e skelës dhe shkallëve prej druri;
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për punimin e skelës dhe shkallëve prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2** **Nxënësi punon në makina materialin drunor për skelë dhe shkallë prej druri.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë lëndën e parë për prodhimin e skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri sipas skicës;
- të shkurtojë materialin drunor për pjesët e kambalecit dhe shtresës së skelës, për mbështetësen anësore, shkelsen dhe ballloren e shkallës;
- të sharrojë materialin drunor për pjesët e kambalecit dhe

shtresës së skelës për mbështetësen anësore, shkelsen dhe balloren e shkallës;
- të drejtojë materialin me makinën plan dhe grosecë;
- të presë detalet me përmasa fikse;
- të hapë foletë në pjesët e kambalecit sipas skicës;
- te realizoje thithat sipas foleve për të gjitha lidhjet;
- të bëjë saktë kllapat me sharra dore;
- të hapi kanalet në pjesët e shtresës të skelës dhe të përbërseve të shkallëve sipas përmasave në skicë;
- të montojë me kujdes elementët për formimin e kambalecit dhe shtresës të skelës me lëndë ngjitëse;
- të montojë me kujdes mbështetësen e shkallës;
- Të montojë sipas skicës shkelëset dhe balloret, të bëjë veshje me gomë të shtresës të skelës sipas modelit;
- të lyejë me bojë ose antiseptikë kambalecin dhe shtresën e skelës prej druri sipas kërkesës;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së skelës së thjeshtë dhe shkallës prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3** **Nxënësi punon për montimin e skelës së thjeshtë prej druri të muratorit.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të afrojë sipas vëndit, në skicë detalet e skelës;
- të bëjë montimin paraprak të elementeve përbërës të skelës;
- të bëjë korrigjimin e gabimeve, në se do ketë;
- të lyejë me lëndë ngjitëse elementët që do lidhen;
- të montojë me kujdes elementët për formimin e kambalecit;
- të veshi me gomë shtresën e skelës me lëndë ngjitëse, me kujdes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të skelës së thjeshtë të muratorit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4** **Nxënësi punon për montimin e shkallëve prej druri**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të bashkojë paraprakisht elementet për mbështetëset anësore të shkallëve;
- të montojë me kujdes mbështetësen anësore të shkallës;
- të montojë sipas skicës balloren e shkallës së parë;
- të montojë shkelësen e shkallës së parë;
- të montojë me rradhë të gjitha balloret dhe shkelëset sipas

numrit në skicë;
- të bëjë fiksimin përfundimtar të tyre;
- të lyejë me antiseptikë, bojë, llak etj. shkallët sipas kërkesës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të shkallëve prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 5** **Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për punimin e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të realizojë llogaritjet ekonomike për punimin e skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri ;
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet;
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqerore, etj.);
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.);
- të llogaritë detyrimet fiskale në bisneset e vogla të profilit Mobileri dhe tapiceri;
- të llogaritë të ardhurat, fitimin në një bisnes të vogël Mobileri dhe tapiceri gjatë prodhimit të skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri;
- të hartojë preventivin (për materiale)( mendoj) përfundimtar për punimin e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri;
- Përgatitja e faturës, për koston e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të njohë Marketingun e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën);

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve për prodhimin e skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të prodhimit të skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri, në mënyrë të pavarur në grupe.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e

| | |
|---|---|
| | nxënësve. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Reparti për punime druri.<br>– Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të drurit.<br>– Instrumenta prerëse.<br>– Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.<br>– Materiale të ndryshme drunore për punimin e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri.<br>– Materiale ndihmëse për punimin e skelës së thjeshtë dhe shkallëve prej druri.<br>– Skica të skelës të thjeshtë dhe shkallëve prej druri.<br>– Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhezuesa.<br>– Kompleti i veshjeve te punës. |